



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 121**

**26 korrik**

**2013**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr. 563, datë 3.7. 2013	Për miratimin e rregullore "Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës" ..... 5205
Vendim i KM nr. 564, datë 3.7.2013	Për miratimin e rregullore "Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës" ..... 5216
Vendim i KM nr. 565, datë 27.6.2013	Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, për vitin akademik 2013-2014..... 5223
Vendim i KM nr. 567, datë 27.6.2013	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Lunxhëri të qarkut të Gjirokastrës..... 5244

**VENDIM**  
**Nr. 563, datë 3.7. 2013**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT PËR PËRDORIMIN E PAJISJEVE MBROJTËSE INDIVIDUALE NË VENDIN E PUNËS”<sup>1</sup>**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 42 të ligjit nr.10 237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullore “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

3. Pikat 16.1 deri te 16.5 të aneksit V të vendimit nr. 312, datë 5.5.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullore “Për sigurinë në kantier””, që kanë të bëjnë me objektin e kësaj rregulloreje, si dhe të gjitha aktet nënligjore që bien ndesh me këtë rregullore shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**RREGULLORE**  
**PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT PËR PËRDORIMIN E PAJISJEVE MBROJTËSE INDIVIDUALE NË VENDIN E PUNËS**

**Neni 1**

**Objekti dhe fusha e zbatimit**

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale, më poshtë referuar si PMI, në vendin e punës, të nevojshme për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve në punë.

2. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha ndërmarrjet dhe vendet e punës që janë brenda fushës së veprimit të ligjit nr. 10 237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, pavarësisht mënyrës së organizimit, llojit të ndërmarrjes dhe arsyeve për të cilat zhvillohet puna apo trajnimi në vendin e punës.

**Neni 2**

**Pajisjet mbrojtëse individuale**

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, me “Pajisje mbrojtëse individuale” nënkuptohet çdo pajisje që përdoret nga punëmarrësit për t’u mbrojtur nga një apo më shumë rreziqe të cilat rrezikojnë

<sup>1</sup> Ky vendim i Këshillit të Ministrave transponon direktivën e BE-së 89/656/EEC, datë 30 nëntor 1989, për kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë për përdorimin nga punonjësit e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës (direktiva e tretë individuale në kuptim të nenit 16(1) të direktivës 89/391/EEC).



sigurinë dhe shëndetin në punë dhe çdo pjesë tjetër shtesë e prodhuar në përmbushje të këtij qëllimi (sipas shtojcës 1).

Nuk do të konsiderohen si pajisje mbrojtëse individuale:

- a) veshjet që nuk janë përcaktuar në mënyrë të veçantë për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e punëmarrësve dhe të vetëpunësuarve;
- b) pajisjet mbrojtëse individuale të veshura apo të përdorura nga forcat e armatosura, Policia e Shtetit dhe emergjencat civile;
- c) pajisjet sportive;
- ç) pajisjet mbrojtëse dhe pajisje parandaluese për vetëmbrojtje;
- d) pajisjet, përfshirë ato të lëvizshme për zbulimin dhe sinjalizimin e risqeve dhe rreziqeve;
- dh) shërbimet e urgjencave dhe të shpëtimit;
- e) mjetet e transportit rrugor.

### Neni 3

#### **Rregulla të përgjithshme**

Pajisjet mbrojtëse individuale përdoren kur risqet nuk mund të shmangen apo zvogëlohen mjaftueshëm me anë të mjeteve teknike të mbrojtjes kolektive apo me masa, metoda dhe procedura të organizimit të punës.

### Neni 4

#### **Detyrimet e përgjithshme të punëdhënësit**

1. Punëdhënësi siguron për punëmarrësit pajisjet mbrojtëse individuale për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të tyre, në përputhje me nenin 3 të kësaj rregulloreje dhe mbi bazën e vlerësimit të riskut të veprimtarive të veçanta të punës.

2. Punëdhënësi bazuar në vlerësimin e riskut, përgatit me shkrim, për secilin profesion, listën e pajisjeve mbrojtëse individuale me të cilat pajiset punëmarrësi, përcakton rregulla të veçanta lidhur me përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale.

3. Punëdhënësi vë në dispozicion, pa pagesë për punëmarrësin, pajisjet mbrojtëse individuale.

4. Punëdhënësi garanton funksionimin e mirë teknik dhe higjienën e pajisjeve mbrojtëse individuale, nëpërmjet mirëmbajtjes, riparimit apo zëvendësimit në rastet e nevojshme.

5. Lista e veprimtarive të punës në të cilat sigurohen/ofrohen pajisjet mbrojtëse individuale ndodhet në shtojcën II bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

### Neni 5

#### **Kërkesa për pajisjet mbrojtëse individuale**

1. Pajisjet mbrojtëse individuale janë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, legjislacionin në fuqi, mbi konformitetin e PMI-së, higjienën, si dhe standardet ndërkombëtare të lidhura me to.

2. Pajisjet mbrojtëse individuale të ofruara duhet të jenë të certifikuara dhe të shënuara me shenjën CE.

3. Të gjitha pajisjet mbrojtëse individuale:

a) sigurojnë mbrojtje të përshtatshme ndaj një rreziku ekzistues dhe/ose të pritshëm, pa shkaktuar vetë ndonjë risk të shtuar;

b) përputhen me kushtet ekzistuese të vendit të punës përfshirë dhe ndryshimet e pritshme të tyre;

c) marrin parasysh kërkesat ergonomike të cilat lidhen me mënyrën e prodhimit të pajisjeve që i përshtaten trupit të njeriut, me qëllim zvogëlimin e sforcimit fizik, paretisë dhe risqeve;

ç) marrin parasysh gjendjen shëndetësore të punëmarrësve;

d) i përshtaten masës së përdoruesit dhe nëse është e nevojshme, i bëhen rregullimet e duhura;

4. Pajisjet mbrojtëse individuale janë të përshtatshme me njëra-tjetrën dhe të mbeten të efektshme kundër rreziqeve në rastet kur ka më shumë se një rrezik dhe punëmarrësit përdorin në të njëjtën kohë më shumë se një PMI.

5. Kushtet në të cilat një pajisje e mbrojtjes individuale përdoret, si dhe kohëzgjatja e përdorimit, përcaktohen në funksion të shkallës së riskut, shpeshtësisë së ekspozimit ndaj rrezikut, karakteristikave të vendit të punës për çdo punëmarrës, si dhe efektshmërisë së pajisjeve mbrojtëse individuale.

6. Në përgjithësi, pajisjet mbrojtëse individuale janë të parashikuara për përdorim vetjak.

Kur pajisjet mbrojtëse individuale përdoren nga më shumë se një punëmarrës, merren masat e duhura për të parandaluar krijimin e problemeve higjienike dhe shëndetësore.

#### Neni 6

##### **Vlerësimi i riskut për përzgjedhjen e pajisjeve mbrojtëse individuale**

1. Punëdhënësi vlerëson nëse pajisjet mbrojtëse individuale plotësojnë kërkesat e nenit 5, përpara zgjedhjes së tyre. Ky vlerësim përfshin:

a) identifikimin e rreziqeve, ndaj të cilave mund të ekspozohen punëmarrësit;

b) analizën dhe vlerësimin e risqeve që mund të shmangen me mjete të tjera;

c) përcaktimin e karakteristikave që çdo pajisje mbrojtëse individuale duhet të ketë për të qenë e efektshme kundër rreziqeve përkatëse, duke marrë parasysh edhe riskun që mund të krijohet nga përdorimi i tyre;

ç) krahasimin e karakteristikave të pajisjeve mbrojtëse individuale në dispozicion me karakteristikat e përmendura në shkronjën “c”;

d) përgatitjen e dokumentit përfundimtar mbi vlerësimin e pajisjeve mbrojtëse individuale dhe hartimin e listës së pajisjeve mbrojtëse individuale për çdo rrezik dhe profesion (sipas shtojcës 3 bashkëlidhur).

2. Vlerësimi i kërkesave të pikës 1 të këtij neni rishikohet nëse bëhen ndryshime në proceset e punës, kushtet e punës, vendet e punës dhe organizimi i punës.

#### Neni 7

##### **Informimi, formimi, konsultimi dhe pjesëmarrja**

1. Punëmarrësve u sigurohet dhe u vihet në dispozicion informacion i përshtatshëm për çdo artikull të pajisjeve mbrojtëse individuale dhe kusht të përdorimit të tyre.

2. Punëdhënësi informon paraprakisht punëmarrësit për risqet nga të cilat i mbron përdorimi i pajisjeve mbrojtëse individuale. Udhëzimet përkatëse duhet të jenë të kuptueshme për punëmarrësit.

3. Punëdhënësi organizon trajnime dhe, kur është e nevojshme, organizon demonstrime për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale.

4. Konsultimi dhe pjesëmarrja e punëmarrësve dhe/ose përfaqësuesve të tyre për përzgjedhjen, sigurimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mbrojtëse individuale, si dhe artikujve të tjerë që mbulohen nga kjo rregullore kryhet në përputhje me nenin 13 të ligjit nr. 10 237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.

5. Punëmarrësit janë të detyruar të përdorin pajisjet mbrojtëse individuale në përputhje me udhëzimet e punëdhënësit dhe prodhuesit.



## SHTOJCA I LISTË JOSHTERUESE E ARTIKUJVE TË PAJISJEVE MBROJTËSE INDIVIDUALE

1. Mbrojtja e kokës
  - 1.1 Kaska mbrojtëse për përdorim në industri (miniera, kantiere ndërtimi, përdorime të tjera industriale).
  - 1.2 Mbrojtja e lëkurës së kokës (kapelë, beretë, rrjetë për flokë me ose pa strehë për sytë).
  - 1.3 Kokore mbrojtëse (beretë, kapelë, kapelë me lidhëse etj., me pëlhurë, me pëlhurë mbrojtëse etj.).
2. Mbrojtja e dëgjimit
  - 2.1 Tapa veshësh dhe pajisje të ngjashme.
  - 2.2 Kaskë mbrojtëse të plota akustike.
  - 2.3 Kufjet që mund t'i vendosen kaskave industriale.
  - 2.4 Mbrojtëse (kufje) veshi me aparat dëgjimi me lak induksioni LF.
  - 2.5 Mbrojtëse veshi me pajisje kufje me mikrofon.
3. MBROJTJA E SYVE DHE E FYTYRËS
  - 3.1 Syze.
  - 3.2. Syze hermetike.
  - 3.3. Syze me rreze X, syze për rreze laser, ultraviolet, infra të kuqe, syze të rrezatimit të dukshëm.
  - 3.4 Mbrojtëse për fytyrën.
  - 3.5 Maska për saldim (maska dore, maska që lidhen në kokë apo maska që mund t'i vendosen kaskave mbrojtëse).
4. MBROJTJA E FRYMËMARRJES
  - 4.1 Filtrat e pluhurit, filtrat e gazit dhe filtrat e pluhurit radioaktiv.
  - 4.2 Pajisje izoluese me furnizim ajri.
  - 4.3 Pajisje të frymëmarrjes, përfshirë maskën e lëvizshme të saldimit.
  - 4.4 Pajisje zhytjeje.
  - 4.5 Kostume zhytjeje.
5. MBROJTJA E DUARVE DHE E KRAHËVE
  - 5.1 Doreza me gishta që sigurojnë mbrojtje:
    - nga makineritë (shpimet, prerjet, dridhjet etj.);
    - nga lëndët kimike;
    - nga elektriciteti dhe nga të nxehtit.
  - 5.2 Doreza me gishta të bashkuar
  - 5.3 Gishtëza
  - 5.4 Mbi mëngë
  - 5.5 Mbrojtëse të kyçit të dorës për punë të rëndë
  - 5.6 Doreza pa gishta
  - 5.7 Doreza mbrojtëse
6. MBROJTJA E SHPUTAVE TË KËMBËVE DHE E KËMBËVE
  - 6.1 Këpucë të sheshta, çizme deri te kyçi i këmbës, çizme me gjatësi deri te pulpa e këmbës, çizme të sigurisë.
  - 6.2 Këpucë të cilat mund të zgjidhen apo hiqen me shpejtësi.
  - 6.3 Këpucë me kapak mbrojtës shtesë në majë.
  - 6.4 Këpucë, çizme dhe mbi-çizme me shuall rezistuese ndaj të nxehtit.
  - 6.5 Këpucë, çizme dhe mbi-çizme rezistuese ndaj të nxehtit.
  - 6.6 Këpucë, çizme dhe mbi-çizme termike.
  - 6.7 Këpucë, çizme dhe mbi-çizme rezistuese ndaj dridhjeve.

- 6.8 Këpucë, çizme dhe mbi-çizme kundër elektrizimit.
- 6.9 Këpucë, çizme dhe mbi-çizme izoluese.
- 6.10 Çizme mbrojtëse për operatorët e sharrave me zinxhir.
- 6.11 Nallane.
- 6.12 Gjunjëza.
- 6.13 Mbrojtës të çmontueshëm në qafën e këmbës.
- 6.14 Qafore e çmontueshme këpucësh.
- 6.15 Shuall i çmontueshëm (që nuk e përçon nxehtësinë, i pashpueshëm dhe kundër djersës).
- 6.16 Thumba të çmontueshëm për akull, borë ose dysheme të rrëshqitshme.
- 7. MBROJTJA E LËKURËS  
Kremra/pomada mbrojtëse.
- 8. MBROJTJA E TRUNGUT DHE E BARKUT
  - 8.1 Jelekë, xhaketa mbrojtëse dhe përparëse për të siguruar mbrojtje nga makineritë (shpimet, prerjet, spërkatje me pika metali të shkrirë etj.).
  - 8.2 Jelekë, xhaketa mbrojtëse dhe përparëse për të siguruar mbrojtje nga lëndët kimike.
  - 8.3 Jelekë me ngrohje.
  - 8.4 Jelekë shpëtimi.
  - 8.5 Përparëse për mbrojtje nga rrezet X.
  - 8.6 Ripa mesi sigurie.
- 9. MBROJTJA E TË GJITHË TRUPIT
  - 9.1 Pajisje të projektuara për të parandaluar rëniet.
  - 9.2 Pajisje për parandalimin e rënieve (pajisje të plota me të gjithë aksesorët e nevojshëm).
  - 9.3 Pajisje frenuese për thithjen e energjisë kinetike (pajisje të plota me të gjithë aksesorët e nevojshëm).
  - 9.4 Ripa trupi sigurie.
  - 9.5 Veshje mbrojtëse.
  - 9.6 Veshje pune të “sigurisë” (në dy pjesë dhe si kominoshe).
  - 9.7 Veshje që sigurojnë mbrojtje nga makineritë (shpimet, prerjet etj.).
  - 9.8 Veshje që sigurojnë mbrojtje nga lëndët kimike.
  - 9.9 Veshje të sigurojë mbrojtje nga spërkatjet me pika metali të shkrirë dhe nga rrezatimi i rrezeve infra të kuqe.
  - 9.10 Veshje mbrojtëse ndaj nxehtësisë.
  - 9.11 Veshje mbrojtëse ndaj të ftohtit.
  - 9.12 Veshje që sigurojë mbrojtje nga ndotja radioaktive.
  - 9.13 Veshje mbrojtëse nga pluhuri.
  - 9.14 Veshje kundër gazit.
  - 9.15 Veshje dhe pjesë shtesë me sinjalizim fluoreshent, retroreflektues (shirit krahësh, doreza etj.).
  - 9.16 Mbulesa mbrojtëse.

## SHTOJCA II

### LISTË UDHËZUESE JOSHTERUESE E VEPRIMTARIVE DHE SEKTORËVE TË VEPRIMTARISË QË MUND TË KËRKOJNË SIGURIMIN E PAJISJEVE MBROJTËSE INDIVIDUALE

- 1. MBROJTJA E KOKËS (MBROJTJA E KAFKËS)  
Kaskat mbrojtëse
  - 1.1 Punë ndërtuese, punë të kryera mbi, nën ose në afërsi të skelave dhe vendeve të punës të ngritura, ndërtim dhe heqje armature, montim dhe instalim dhe punë për shembjen e objekteve.











































































Tabela nr.2

KUOTAT PËR KANDIDATËT E TROJEVE, NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË,  
PËR VITIN AKADEMIK 2013 – 2014

Emërtimi i universitetit	Emërtimi i fakultetit	ID programit	Emërtimi i programit	Kuotat për studentët nga Kosova	Kuotat për studentët shqiptarë nga Mali i Zi	Kuotat për studentët shqiptarë nga Maqedonia	Kuotat për studentët shqiptarë nga Presheva, Bujanovci dhe Medvegja	Kuotat totale Kosova + trojet
	dhe Shkencave Humane							
Universiteti "Fan Noli" Korçë	Fakulteti Ekonomik	112	Financë - Kontabilitet	0	0	2	0	2
Universiteti "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave Shoqërore	178	Gjuhë – Letërsi	0	3	0	0	3
Universiteti "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave Shoqërore	179	Gazetari dhe Komunikim	0	3	0	0	3
Universiteti "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave Natyrore	184	Informatikë	0	10	0	0	10
Universiteti "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave Natyrore	185	Biologji - Kimi	0	3	0	0	3
Universiteti "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave Natyrore	186	Infermieri e Përgjithshme	0	12	0	0	12
Universiteti "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave Natyrore	187	Infermieri (Mami)	0		0	0	0
Universiteti "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave Natyrore	188	Infermieri (Fizioterapi)	0	10	0	0	10
Universiteti "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	189	Mësuesi për Arsimin Fillor Kl. I-VI	0	10	0	0	10
Universiteti "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	190	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	0	8	0	0	8
Universiteti "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	191	Psikologji	0	5	0	0	5
Universiteti "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	192	Punë Sociale	0	5	0	0	5
Universiteti "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	193	Edukim Fizik dhe Sporte	0	7	0	0	7
Universiteti "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Ekonomisë	194	Financë - Kontabilitet	0	7	0	0	7
Universiteti "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Ekonomisë	195	Administrim - Biznes	0	8	0	0	8
Universiteti "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Ekonomisë	196	Turizëm	0	15	0	0	15
Universiteti "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	197	Gjuhë Angleze	0	4	0	0	4
Universiteti "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	199	Gjuhë Gjermane	0	3	0	0	3
Universiteti "L.Gurakuqi" Shkodër	Fakulteti i Drejtësisë	201	Drejtesia	0	7	0	0	7
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	285	Regji Filmi dhe TV	3	1	1	1	6
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	286	Akrim	2	1	1	1	5
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	287	Regji	2	1	1	1	5
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Skenik	288	Skenografi - Kostumografi	2	1	1	1	5
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Artit Figurativ	290	Pikturë	2	2	2	2	8
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	310	Pedagogji Muzikore	2	2	2	2	8
Universiteti i Arteve Tiranë	Fakulteti i Muzikës	311	Fizarmonikë Klasike	0				0

Tabela nr.2

KUOTAT PËR KANDIDATËT E TROJEVE, NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË,  
PËR VITIN AKADEMIK 2013 – 2014

Emërtimi i universitetit	Emërtimi i fakultetit	ID programit	Emërtimi i programit	Kuotat për studentët nga Kosova	Kuotat për studentët shqiptarë nga Mali i Zi	Kuotat për studentët shqiptarë nga Maqedonia	Kuotat për studentët shqiptarë nga Presheva, Bujanovci dhe Medvegja	Kuotat totale Kosova + trojet
Universiteti i Sporteve Tiranë	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	312	Shkencat e Lëvizjes	2	2	2	2	8
Universiteti i Sporteve Tiranë	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	313	Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit	2	2	2	2	8
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Muzikës	318	Dirigjim	0	2	0	0	2
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Artit Figurativ	319	Pikturë	0	2	0	0	2
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Artit Figurativ	320	Pikturë - Grafikë	0	2	0	0	2
Akademia e Arteve, Shkodër	Fakulteti i Artit Figurativ	322	Pedagogji Muzikore	0	2	0	0	2
			<b>TOTALI</b>	<b>139</b>	<b>243</b>	<b>172</b>	<b>146</b>	<b>700</b>





**VENDIM**  
**Nr. 567, datë 27.6.2013**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS LUNXHËRI TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Lunxhëri të qarkut të Gjirokastrës që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 99 (nëntëdhjetë e nëntë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 701 (shtatëqind e një).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Lunxhëri për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Komuna Lunxhëri

Lidhja nr. 1

<b>Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit</b>	<b>Fusha e përdorimit të pronës</b>	<b>Lloji i transferimit</b>
1-5, 701	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën arsimore	Në pronësi
6-7	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e kulturës	Në pronësi
8	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
10-14	Varrezat publike	Në pronësi
15-19, 21, 29, 30, 38, 62, 63, 66-68, 80-82, 85, 89, 91-101, 113-116, 147	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
20, 24, 25, 28, 34-37, 39-46, 48-53, 57-59, 61, 64, 65, 69-79, 83, 84, 86-88, 90, 102-112, 118, 121-146, 149, 150, 154-446	Infrastrukturë (rrugë vendore, sheshe, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
22, 23, 26, 27, 31-33, 47, 54-56, 60, 117, 148, 151-153	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
447-449	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e mbrojtjes civile	Në pronësi
450-451	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Hyri në shtyp më 26.7.2013  
Doli nga shtypi më 26.7.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 48 lekë